




Grupi i Punës 4

Fondet Strukturore

4 sesione u zhvilluan në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit si një nga institucionet kryesore për negociatat e kapitullit 22.

Institucionet Pjesëmarrëse

Në Grupin e katërt të Punës u përfshinë 36 institucione dhe 92 pjesëmarrës.



Kapitulli 22

Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore është i një rëndësie të madhe për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të programit kombëtar IPA si dhe në administrimin e fondeve të BE. Legjislacioni në kuadër të këtij kapitulli përcakton rregullat mbi hartimin, miratimin dhe implementimin e Fondeve Strukturore dhe Programet e Fondit të Kohesionit.

Periudha e zhvillimit të sesioneve

Tetor 2020 - Qershor 2021

Rekomandimet:



- Është i nevojshëm fuqizimi i kapaciteteve administrative sidomos në fushat e planifikimit dhe programimit; zbatimin e programeve IPA; menaxhimit të financave dhe kontrollit të brendshëm, si dhe aftësitë përthithëse të fondeve të BE. Për të realizuar këtë rekomandohen zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin përgjegjës; bashkëpunimi me Shtetet Anëtare të BE për të ofruar mbështetje teknike dhe financiare.
- Përfshirja e aktorëve të tjerë të interesit si bizneset, shoqëria civile apo ekspertët është i nevojshëm sidomos gjatë realizimit të planeve strategjike dhe programeve të financimit, strategjive dhe fushave të interesit sidomos në fushat e energjisë, mjedisit, turizmit, shëndetësisë apo infrastrukturës. Aktorët lokalë si bashkitë duhet të përfshihen gjithashtu, si aktorë me rëndësi për zbatimin e suksesshëm të këtyre programeve.
- Sistemi i zbatimit të projekteve duhet të jetë sa më i thjeshtë dhe jo shumë i ndërlikuar, në mënyrë që të gjithë aktorët e përfshirë të jenë të qartë për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zbatimin e këtij programi dhe së dyti monitorimi i tij të jetë gjithashtu i qartë për autoritet menaxhuese dhe monitoruese. Rekomandohet realizimi i dokumenteve strategjike dhe udhëzuesve të ndryshëm për aktorët e përfshirë.